

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar raportues e Tonka Berishaj, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve S.H. për shkak të veprave penale vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK, veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 dhe veprës penale pengimi i pësonit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KPRK, dhe të akuzuarit P.R. dhe A.H., për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.H. av.Sh.P., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.241/2016, të dt.11.10.2017, ne seancën publike të kolegjit të mbajtur, me dt.11.01.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.H. av.Sh.P. dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.241/2016, të dt.11.10.2017, vërtetohet.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore-DKR, në Gjilan, me aktgjykimin e saj, PKR.nr.241/2016, të dt.11.10.2017, i ka shpallur fajtor të akuzuarit S.H. për veprat penale edhe atë; vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KPRK dhe veprën penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 par.5 lidhur me par.1 të KPRK, të akuzuari P.R. dhe A.H., për veprën penale pjesëmarrja në rrahje, nga neni 190 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Të akuzuarit S.H. i ka përcaktuar dënimet për veprën e parë penale në pikën I.1, ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)viteve, për veprën penale në pikën I.2, ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6(gjashtë)muajve, kurse për veprën penalë në pikën I.3, ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë)muajve, pastaj gjykata konformë të nenit 80 të KPRK, të akuzuarit S.H. i shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, kurse të akuzuarve A.H. dhe P.R., ju cakton secilit veç e veç dënimin me gjobë në shumën prej nga 500(pesëqind)Euro, të cilën shumë prej nga 500(pesëqind)Euro, detyrohen që ta përmbushin secili veç e veç në tri këste në muaj edhe atë këstin e parë në shumën prej 168(njëqindegjashtëdhjetë)Euro,

kurse dy këstet tjera prej nga 166(njëqindegjashtëdhjetegjashtë)Euro, mirëpo, nëse të akuzuarit A. dhe P. nuk donë ose nuk mund ta paguajnë dënimin e shqiptuar me gjobë, në kuptim të nenit 46 par.3 të KPRK, secili veç e veç dënimi me gjobë do të ju zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 25(njëzetepesë)ditëve, të cilin detyrohen që të fillojnë ta mbajnë në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të ftesave nga gjykata nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Të akuzuarit S.H. në dënimin unik të shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)viteve, do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.07.09.2016 e gjerë me dt.01.02.2017, kurse të akuzuarve A.H. dhe P. R., në dënimet e shqiptuara me gjobë do t'ju llogaritet secilit veç e veç koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt.07.09.2016 e gjerë me dt.06.10.2016, ashtu që për një ditë të arrestit shtëpiak, secilit të akuzuar do t'iu llogaritet me 20Euro, nga dënimi i shqiptuar me gjobë.

Të akuzuarit janë detyruar, që t'ia paguajë shpenzimet e procedurës penale edhe atë i akuzuari S.H. përkitazi me tri ekspertizat mjeko ligjore shumë prej 81(tetëdhjetenjë)Euro, e 76(shtatëdhjetegjashtë)cent, kurse për paushall gjyqësor shumë prej 100(njëqind)Euro, ndërsa dy të akuzuarit tjerë A.H. dhe P.R., detyrohen që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumat prej nga 70Euro, të gjitha në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit A.H. dhe F.R. për realizmin e kërkesave pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregull civil.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-Mbrojtësi i të akuzuarit S.H. av.Sh.P., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.533/2017, të dt.15.02.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.H. av.Sh.P., ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, caktoi seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën të nenit 390 të KPP, ku morën pjesë i akuzuari S.H. dhe mbrojtës i tij av.Sh.P., ndërsa nuk prezantuan Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë, të akuzuarit A.H. e P.R., si dhe të dëmtuarit F.R., N.S. dhe A.H., edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre për arsye se pjesëmarrja e tyre

Gjykata e Apelit, konformë nenit 394 par.1 të KPP, pasi që vlerësoi ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.H. si dhe të sqarimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.H. av.Sh.P., është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të paraqitura dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.H. në ankesën e tij, pretendon se përveç rrethanave lehtësuese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, nuk janë vlerësuar rrethanat

tjera lehtësuese dhe atë se i akuzuari S.H. nuk ka ra ndesh me ligjin, se i njëjti gëzon si personalitet respekt dhe sjellje të kënaqshme në rrethin ku jeton, se i njëjti është i gjendjes ekonomike dhe familjare të rëndë, për arsye se burim i mjeteve të realizuara me mund përmbushi kërkesat elementare të familjes së tij shumë anëtarësh.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit S.H. e sipas detyrës zyrtare në kuptim të ekzistimit të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1, dhe të shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit S.H. dhe vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes dhe matjes së vendimit, ka marrë parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, të paraparë si në nenin 73 të KPRK-së, si dhe rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit të paraparë si në nenin 74 të KPRK dhe gjykata, drejtë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, se i akuzuari S.H. ka pranuar fajësinë, se është penduar dhe ka shprehur keqardhje për veprat penale të kryera, si dhe ka vlerësuar edhe rrethanat tjera të cekura në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka ra ndesh me ligjin, gjë që nënkupton se sjelljet e tija të mëparshme kanë qenë në harmoni me normat pozitive, e të cilat rrethana Gjykata e Apelit i merr si të vërtetuara, e të cilat janë paraqitur edhe në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit. Në mungesë të ndonjë rrethane posaçërisht lehtësuese e duke marrë parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë, e në kuadër të vlerësimit të rrethanave të cekura më lartë, gjykata drejt ka aplikuar nenin 75 par.1 nën par.1.3 të KPRK dhe të akuzuarit ia ka shqiptuar dënimin unik nën minimumin e paraparë ligjor, kjo për arsye se në rastet kur i akuzuari pranon fajësinë gjykata ka bërë zbutjen e dënimit, por nuk detyrohet në kufizimet e parapara si në dispozitën e cekur më lartë, siç par.het në dispozitën e nenit 76 të KPRK. Dënimi i shqiptuar unik të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dënimin e këtillë të shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri)vite, ndaj të akuzuarit S.H. pritët të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Si u cekë edhe më lartë u vendos si që ankesat e mbrojtësit të akuzuarit S.H. të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPRK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.568/2017, me dt.11.01.2018**

**Procesmbajtëse,**

**Syzana Goxhuli**

**Anëtarët e Kolegjit**

**Fillim Skoro**

**Tonka Berishaj**

**Kryetari i Kolegjit**

**Xhevdet Abazi**

